



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 707, Datë 23.09.2020

“Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi hapjen e hetimit në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësorë,

VËREN SE :

Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018”, i ka kërkuar Autoritetit “Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë më rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si: tregu bankar, tregu i shërbimeve spitalore dhe tregu farmaceutik,.. etj”.

Nga procedurat e deritanishme, në kuadër të hetimit të përgjithshëm në shërbimin spitalor, janë konstatuar se kostot e barnave dhe investimet në pajisjet mjekësorë përbëjnë një element të rëndësishëm për të qenë konkurrues në tregun spitalor dhe vlerësimi i tij do të sjellë një panoramë më të plotë për të parë ndikimin e tyre në përmirësimin e shërbimit shëndetësor në vend.

Tregu i barnave ka qenë edhe më parë objekt vlerësimi nga Autoriteti, nga ku kemi konstatuar se plotësimi nevojës për barna në vend realizohet në pjesën më të madhe nëpërmjet importit të tyre.

Çmimi i barnave në tregun farmaceutik nuk është element konkurrues pasi fiksimi i tij për të paktën një periudhë 6 muajore dhe përcaktimi i tij në pullën e kontrollit e bën atë të pandryshueshëm, duke sjelle kufizim të konkurrencës me çmimet e produkteve në tregun farmaceutik nga aktorët e këtij tregu.

Oferta për barna në treg është e kufizuar për shkak të shkallës së lartë të fuqisë së tregut nga mbajtësit e patentave apo të drejtave ekskluzive ndërkohë që kërkesa për barna nuk përcaktohet drejtpërsëdrejti nga konsumatori (pacienti), por nga mjeket dhe në këtë mënyrë konsumatori nuk ka mundësi të bëjë zgjedhjen e tij bazuar në çmime më të lira dhe cilësi më të mirë, por si rregull ndjek udhëzimet e doktorit.

Tregu paraqet asimetri në informacion për shkak të marrëdhënieve mes doktorit dhe pacientëve, doktorit dhe prodhuesve/importuesve farmaceutikë, i cili mund të jetë një nga shkaqet kryesore të mosfunksionimit të tregut mbi bazën e kërkesës dhe ofertës.

Ndërkohë tregu i pajisjeve mjekësore është një treg i ri dhe në dinamikë për shkak të zhvillimit teknologjik në fushën e ekzaminimeve shëndetësore. Parë në këtë këndvështrim, është i nevojshëm vlerësimi i kufizimeve që sjellin në treg ekskluzivitetet e dhëna në lidhje me markat e pajisjeve apo shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Autoriteti vlerëson nevojën e një analizë të plotë dhe gjithëpërfshirëse në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, për të parë nëse ka kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës nga ndërmarrjet që operojnë në treg, nëpërmjet të drejtave ekskluzive, fuqisë së konkurrentëve në treg, lidhjes së kontratave kufizuese, të parashikuara në nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore.
2. Hetimi i përgjithshëm të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020.
3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e vendimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS